



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0014490-1/26 dt. 27.03.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 2-të

Koha: 27.03.2026 ora 15:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Fisnik Suma, Armend Begu, Xhyljeta Imeri, Flamur Vojvoda, Gjergj Beka, Jeton Ujkani, Fitim Terziqi, Dzenita Sabani, Sibela Fetahu, Hamide Hyseni dhe Sadete Gashiani

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Komitetit znj. Hamide Hyseni, e cila fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot ka thirrur mbledhjen e dytë të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raport i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për periudhën Janar-Dhjetor 2025

Rendi i ditës u miratua unanimitisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.

Pika 2

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Raportin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Gjatë mbledhjes znj. Dzenita Shabani paraqiti disa sugjerime lidhur me mbikëqyrjen dhe ndarjen e buxhetit nga Zyra për Komunitete (ZKK). Ajo theksoi nevojën për reforma të brendshme në këtë zyrë, përfshirë procesin e përzgjedhjes së drejtorit dhe funksionalizimin e plotë të saj. Gjithashtu ritheksoi rëndësinë e punësimit të përfaqësuesve nga komunitetet përkatëse, rishikimin e buxhetit nga organizatat ndërkombëtare, si dhe mbështetjen e tyre në aktivitete të caktuara.

Z. Armend Begu ngriti çështjen e integritit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shkollat e pjesës jugore të Mitrovicës, duke theksuar se aktualisht ka nxënës nga jugu që ndjekin mësimin në veri të qytetit.

Z. Gjergj Beka theksoi se në Raport të ZKKK-së buxheti është i specifikuar. Po ashtu z. Beka theksoi se anëtarët e Komitetit për Komunitete janë një trupë e përbashkët e Kuvendit dhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet duhet të jenë të unifikuar në dhënien e rekomandimeve.

Znj. Xhyljeta Imeri propozoi hartimin e një statistike të saktë për nxënësit që ndjekin mësimin si në jug ashtu edhe në veri, në mënyrë që të ketë të dhëna të besueshme për planifikim të mëtejshëm.

Znj. Hamide Hyseni u shpreh se shpërndarja e pakove ushqimore duhet të bëhet pa dallim përkatësie etnike dhe kërkoi angazhimin e organizatave dhe fondacioneve për mbështetje. Ajo sugjeroi gjithashtu hartimin e një plani veprimi për këtë çështje.

Z. Jeton Ujkani theksoi se buxheti për vitin aktual tashmë është alokuar dhe duhet të veprohet brenda këtij kuadri. Megjithatë, ai shtoi se për vitin 2027 mund të bëhen ndërhyrje buxhetore dhe ndarje për aktivitete të caktuara. Ai sugjeroi që çdo kërkesë për reforma për këtë vit të përfshihet në rendin e ditës dhe të diskutohet me drejtoritë përkatëse. Gjithashtu theksoi rëndësinë e reformave në arsim për të gjitha komunitetet, përfshirë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe komunitetet e tjera sipas nevojës.

Znj. Dzenita Shabani ritheksoi rëndësinë e mbështetjes së aktiviteteve kulturore pa dallim etnie, duke kërkuar që të sigurohen fonde përkatëse nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe nga Drejtoria e Arsimit.


Në fund, z. Fisnik Suma rekomandoi që për takimin e ardhshëm të përfshihet si pikë e rendit të ditës: “Adresimi i kërkesave nga komunitetet jo-shumicë”.

Mbledhja përfundoj punimet në ora 15:30 min.

Mitrovicë
27.03.2026

Procesmbajtës:

Merita PRETENI

Kryesuesja e Komitetit

Hamide HYSENI